



BASHKIA SHKODER

SPORT DHE ARGËTIM

2020 – 2022


Programi Buxhetor: 08130 - Sport dhe argëtim

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi mbulon operimin ose mbështetjen e strukturave për aktivitete çlodhëse dhe sportive dhe kontribut financiar për promovimin e sporteve. Sigurimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet zinxhire të klubit shumësportësh "Vllaznia". Organizimi dhe mbështetje e programit "Jeto me Sportin", me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit në komunitet


Shpenzimet e Programit buxhetor 2017 – 2022

Kodi	Fakt 2017	Fakt 2018	I Pritshmi 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
08130	94,863	122,500	130,077	97,572	97,572	101,746




Shpenzimet e Programit sipas klasifikimit ekonomik


	Shpenzimet korrente	Investimet
Fakt 2017	90,920	3,943
Fakt 2018	120,440	2,060
I Pritshmi 2019	131,888	21,430
Plan 2020	110,311	4,729
Plan 2021	101,234	1,500
Plan 2022	101,334	1,500




Treguesit Kyç të Performancës



Treguesit e rezultatit	Njësia Matëse	Synimet					Trendi
		2018	2019	2020	2021	2022	
Rritja e eficiencës së mbështetjes buxhetore të veprimtarive sportive dhe argëtuese	Rritja në % e të ardhurave nga eventet kundrejt vitit të kaluar	-57%	102%	142%	4%	4%	↑
Rritja e informimit për aktivitetet sportive	Rritja vjetore në % e publikimeve sportive	100%	50%	33%	25%	100%	↑
Rritja e pjesëmarrësve në aktivitetet sportive	Rritja vjetore në % e pjesëmarrësve në aktivitetet sportive			100%	40%		↑



Treguesit e rezultatit	Njësia Matëse	Synimet					Trendi
		2018	2019	2020	2021	2022	
Rritja e eficiencës së mbështetjes buxhetore të veprimtarive sportive	Mbulimi i shpenzimeve të Klubit Shumësportësh "Vllaznia" (raporti të ardhura me shpenzime në %)	0.3%	0.5%	0.9%	1.3%	1.5%	→



Treguesit e rezultatit	Njësia Matëse	Synimet					Trendi
		2018	2019	2020	2021	2022	
Rritja e mbështetjes për ekipet perfaqesuese të bashkise ne ne veprimtarie sportive ne kampionate kombetare	Ndryshimi i numrit të sportistëve ndër vite (%)		58%	-32%	85%	0%	↑

TË DHËNAT E PROGRAMIT

Fakt 2018	I Pritshmi 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
-----------	-----------------	-----------	-----------	-----------



STRUKTURA PËR VEPRIMTARI SPORTIVE

3	3	3	3	3
---	---	---	---	---



SHPENZIME PËR MBËSHTETJEN E VEPRIMTARIVE SPORTIVE (NË MIJË LEKË)

122,500	130,077	97,572	97,572	101,746
---------	---------	--------	--------	---------



NUMRI I EKIPEVE DHE AKTIVITETEVE SPORTIVE

30	30	30	30
----	----	----	----



NUMRI I SPORTISTËVE TË MBËSHTETUR

240

164

304

304

304



TË ARDHURAT NGA BILETAT E SHITURA (në mijë lekë)

286

573

600

650

700



NUMRI I PUBLIKIMEVE SPORTIVE

2

3

4

5



NUMRI I PJESËMARRËSVE NË AKTIVITETE SPORTIVE

250

500

700

Projektet kryesore të investimeve

Emri i projektit	Viti i zbatimit		Fonde të kontraktuara	Fonde të planifikuara	% e realizimit deri në fund të 2019	Programi buxhetor
	Fillon	Mbaron				
Ndërtim Fusha Sportive	2019	2020	31,4710	3229	90%	08130
Rikonstruktion terren sportive (salla e ndeshjeve lojera me dore 700m2)	2020	2020	0	1,030	0%	08130
Blerje pajisje	2020	2020		370	0%	08130

Aktivitetet Kryesore

Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar gjatë

- 2020 – 2022 janë:
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e strukturave sportive dhe argëtuese për komunitetin
- Rritja e kapaciteteve të ekipeve të futbollit të grup moshave të ndryshme për femra dhe meshkuj
- Rritja e mbështetjes buxhetore të veprimtarive sportive
- Rritja e mbështetjes buxhetore të veprimtarive rinore dhe argëtuese
- Rritja e mbështetjes për ekipet perfaqësuese të bashkise në veprimtari sportive në kampionate kombëtare dhe ndërkombëtare.

Funksioni 8: Argëtimi, kultura dhe feja

Nënfunksioni : 081 Shërbime rekreative dhe sportive

Programi 08130: Sport dhe argëtim

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon operimin ose mbështetjen e strukturave për aktivitete çlodhëse dhe sportive dhe kontribut financiar për promovimin e sporteve.		
08130	Sport dhe argëtim	<ul style="list-style-type: none"> • Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive; mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive. • Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive pasive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me tabelë etj.) • Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe ose konkurrenca apo lojtarë individualë

Qëllimi i politikës	Objektivat Specifik	Treguesi/Indikator	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020	Situata e synuar 2021	Situata e synuar 2022
“Jeto me sportin” Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit në komunitet	O1. Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.	Rritja e efciences se mbeshtetjes buxhetore te veprimtarive rinore e argetuese <i>-Rritja në % e të ardhurave nga eventet kundrejt vitit të kaluar</i>	-57%	102%	142%	4%	4%
		Rritja e informimit për aktivitetet sportive <i>-Rritja vjetore në % e publikimeve sportive</i>	100%	100%	50%	33%	25%
		Rritja e pjesëmarrësve në aktivitetet sportive <i>. Rritja vjetore në % e pjesëmarrësve në aktivitetet sportive</i>			100%	40%	
Krijimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet zinxhire të klubit shumësportësh “Vllaznia	O2. Manaxhimi dhe mireadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi i infrastrukturës së pershtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet	Rrija e efciences se mbeshtetjes buxhetore te veprimtarive sportive. <i>- Mbulimi i shpenzimeve të Klubit Shumësportësh “Vllaznia” (raporti të ardhura me shpenzime në %)</i>	0.3%	0.5%	0.9%	1.3%	1.5%
		Rritja e mbeshtetjes per ekipet perfaqesuese te Bashkise ne veprimtarite sportive ne kampionate kombetare.					
	O3. Garantimi i pjesmarrrjes se te gjithë ekipeve te Klubit Vllaznia ne Kampionatet Kombetare me synim arritjen e rezultateve cilesore	‘-Ndryshimi i numrit të sportistëve ndër vite (%)		58%	-32%	85%	0%

Projekte të rëndësishme				
Kodi projekti	Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit	Buxheti 2020	Buxheti 2021	Buxheti 2022
P08130.O1.A1	Maratona e pavarësisë Ulqin – Shkodër	415	300	400
P08130.O1.A2	Aktivitete për arsimin, rininë dhe sportin gjatë vitit	1,096	1,096	1,096
P08130.O1.A3	Beach voley, volejboll	1,252	1,300	1,300
P08130.O1.A4.	"Memorial Vllaznia" në boks.	400	400	400
P08130.O1.A5	Ndërtim fusha sportive	3,229		
P08130.O2.A1	Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia	25,387	25,825	25,825
P08130.O2.A2	Administrim dhe mirëmbajtje e objekteve/terreneve sportive në pronësi të	18,250	8,800	8,800
P08130.O2.A3	Administrimi i Klubit të Futbollit Vllaznia	44,000	45,000	45,000
P08130.O3.A1	Ekipi i basketbollit i te rriturve per meshkuj	2,336	2,665	2,665
P08130.O3.A2	Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj te rinj	326	275	275
P08130.O3.A3	Mbështetje e ekipit të basketbollit femra te rritura	2,068	2,425	2,425
P08130.O3.A4	Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja	333	280	280
P08130.O3.A5	Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur	3,236	2,641	2,641
P08130.O3.A6	Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura	2,236	2,440	2,440
P08130.O3.A7	Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj	244	241	241
P08130.O3.A8.	Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja	226	365	365
P08130.O3.A9	Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj	2,334	2,334	2,334
P08130.O3.A10	Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur	2,322	2,322	2,322



P08130.O3.A11.	Mbështetje e ekipit Çiklizëm meshkuj të rritur	1,118	1,118	1,118
P08130.O3.A12	Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës femra të rritura	414	714	714
P08130.O3.A13.	Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur dhe të rinj	2	2	2
P08130.O3.A14	Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj të rritur	407	407	407
P08130.O3.A15	Mbështetje e ekipit të Notit të rritur dhe të rritura	125	25	25
P08130.O3.A16	Mbështetje e ekipit të peshngritjes meshkuj të rritur	233	433	433
P08130.O3.A17.	Mbështetje e ekipit të Ping - Pong të rritur.	5	5	5
P08130.O3.A18	Mbështetje e ekipit të Shahut të rritur	405	5	5
P08130.O3.A19	Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rritur/të rritura	436	436	436
P08130.O3.A20	Mbështetje e ekipit të boksit femra	625	625	625
P08130.O3.A21	Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja	432	105	105
P08130.O3.A22	Mbështetje e ekipit të atletikës femra	150	150	150
P08130.O3.A23	Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura	1000		



Të dhënat e programit	2018	2019	2020	2021	Trendi
Struktura për veprimtari sportive	3	3	3	3	3
Numri i stafit Sport Klub Vllaznia: Kohe te plote:	21	21	21	21	21
Kohe te pjesshme	0	0	37	37	37
Nr i ekipeve	22	22	23	23	23
Nr i sportistëve	152	164	304	304	304
Nr i disiplinave sportive te mbeshtetura	16	16	17	17	18
Nr. Pjesemarresish ne aktivitetet sportive		250	500	700	
Nr. Publikime sportive	0	1	2	3	4
Të ardhurat nga biletat e shitura (në mijë lekë)	286	573	600	650	700

Informacion financiar në mijë lekë						
Vitet	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Tavani i përgjithshëm i programit				115,042	102,734	102,834
Shpenzimet bruto	94,863	122,500	171,242	115,042	102,734	102,834
Të ardhurat e programit	662	286	15,290	4629	1450	1500
Shpenzimet neto	94,201	122,214	155,952	110,413	101,284	101,334
Pagat dhe sigurimet shoqërore				21,061	21,374	21,374
Investimet kapitale	3,943	2,060	29,904	4,729	1,500	1,500

Komente

Programi 08130: Sport dhe argetim ka si burim financimi kryesisht tranferten e pakushtezuar dhe te ardhurat e tjera si dhe te ardhurat qe mbidhen nga vete institucionet sportive. Ndersa shpenzimet neto jane shpenzime qe mbulohen nga te ardhurat e bashkise dhe transferta e pakushtezuar me nje mesatare prej 96.6%. Pjesen me te madhe te shpenzimeve e zene shpenzimet korrente me rreth 77.6% ne vitin 2020, 77.7% ne vitin 2021 dhe 77.8% ne vitin 2022. Ndersa shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore zene 18.3% ne vitin 2020, 20.8% ne vitin 2021 dhe 20.8% ne vitin 2022. Shpenzimet kapitale zene 4.1% ne vitin 2020, 1.5% ne vitin 2021 dhe 1.5% ne vitin 2022.

Nr. 1	Projekti: P08130.O1.A1 Maratona e pavarësisë Ulqin – Shkodër	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081 Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130 Sport dhe argëtim					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit : Maratone vrapimi 42 km Ulqin - Shkodër							
i. Situata							
<p>Maratona e Pavarësisë Ulqin - Shkodër zhvillohet që nga viti 2012 me datën 28 Nëntor si një mënyre sportive për të bashkuar dy vende fqinje me tradita të ngjashme. Kjo Maratonë ndryshon çdo vit nisjen e saj, një vit niset nga Ulqini dhe një vit nga Shkodra, këtë vit Maratona niset nga Shkodra për të mbërritur në Ulqin. Vit pas viti iu bashkuan Maratones edhe fëmijë, por edhe të rinj të cilët e shoqërojnë maratonen edhe me biçikleta.</p> <p>Maratona e Pavarësisë është një rast i suksesshëm i bashkëpunimit dhe i gjithë-përfshirjes. Nga viti në vit pjesëmarrësit janë nga vende të largëta jo vetem nga Ballkani por edhe më larg.</p> <p>Gjatë shtatë viteve të fundit në këtë aktivitet kanë marrë pjesë rreth 500 meshkuj, 200 femra dhe rreth 150 atletë dhe amatorë në total. Pjesëmarrësit ishin nga Shqipëria, Kosova, Rusia, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia etj.</p> <p>Ky aktivitet vazhdon të promovojë marrëdhëniet e ndërsjellta dhe fqinjësinë e mirë duke bashkuar sportin, turizmin dhe kulturën mes dy vendeve.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none">Promovimin e aktivitete sportive për të rinjtë.Rritjen e bashkëpunimit të atletëve dhe sportistëve të vendeve fqinje.Bashkëpunimin e njësive vendore të Shkodrës dhe të Ulqinit.Promovimi i zgjerimit të gjeografisë së pjesëmarrësve me synim ndërkombëtarizimin e kësaj veprimtarie.Përfshirjen e kësaj veprimtarie sportive në axhendën e veprimtarive sportive kombëtare.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none">Ngritja e grupit organizator me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Bashkisë së Shkodrës dhe të Komunës së Ulqinit.Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve promovuese dhe mediatike për aktivitetin.Përfshirja e Maratonës në axhendën e aktiviteteve të Javës së Pavarësisë 2020.Organizimi i nisjes së atletëve nga Shkodra.							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none">Gara e Maratonës të bëhet pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të javës së Pavarësisë 2020.Numri dhe gjeografia e pjesëmarrësve të atletëve në këtë aktivitet, të jetë i rritur nga gjithë Shqipëria, Kosova e më tej.Promovimi i fqinjësisë së mirë dhe marrëdhënieve ndërmjet vendeve tona përmes aktiviteteve sportive e kulturore.							
c) Aktoret e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
Komuna e Ulqinit Ojft-të Të rinjtë Sportistë Qytetarë sport dashes Dashamirë të atletikës			Bashkia Shkodër Komuna e Ulqinit				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Materiale publicitare	60			60		
A.2	Transport	15			15		
A.3	Çmimet për fituesit: Vendi i parë për dy kategori 2x70000 Vendi i dytë për dy kategori 2x50000 Vendi i tretë për dy kategori 2x40000	280			280		
A.4	Trajtim ushqimor	60			60		
Shuma		415			415		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferim	Kapitale



					e	
A.1	Shpenzime operative	300			300	
	Shuma	300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Shpenzime operative	400			400	
	Shuma	400			400	
f) Periudha e zbatimit 2020 2021 2022		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër				



Nr. 2	Projekti: P08130.O1.A2 Aktivitete për arsimin, rininë dhe sportin gjatë vitit	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081 Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130 Sport dhe argëtim
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit : Aktivitete rinore, sportive në territorin e Bashkisë Shkodër		
i. Situata		
<ul style="list-style-type: none"> Festivali i shahut Loja e shahut ka një traditë pozitive dhe të hershme në qytetin e Shkodrës. Tradicionalisht pranë klubit Vllaznia ka funksionuar ekipi i shahut për meshkuj dhe femra, të cilët kanë arritur rezultate sportive shumë të mira në vite, duke u shpallur, disa prej tyre edhe Kampion Kombëtar. Sporti i shahut është një nga sportet që ndihmon në zhvillimin pozitiv të aftësive njohëse të fëmijëve dhe nxënësve. Njëkohësisht ndikon në krijimin e besimit në vetvete, rritjen e kujtesës e të menduarit, rritjen e përqendrimit dhe të përmirësimit të rezultateve në mësimet tek fëmijët dhe të rinjtë. Bashkia Shkodër, në vitin 2019 mbështeti aktivitetin disa ditë të zhvilluar në Qendren Kulturore të Fëmijëve, si dhe organizoi projektin "Festivali i Shahut" në Mars 2019 në Qendren Rinore "Atelie" ku morën pjesë moshë të reja dhe dolën fitues për çdo kategori. Në vitin 2020 synohet të përsëritet ky aktivitet duke kaluar disa faza, që nga QKF, në përfshirjen e gjimnazistëve si dhe të veteranëve; duke krijuar kështu larmi dhe përfshirje të gjërë. Revista sportive "Vllaznia" Bashkia Shkodër ndër vite financon ekepe të disiplinave sportive të ndryshme, duke i mbështetur për një nivel dhe paraqitje sportive gjithmonë në rritje. Duke vazhduar traditën dhe duke qënë një ndër SK me rezultate më të larta në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtar Bashkia Shkodër në projektet e saj ka edhe hapjen në vazhdim të kufijve për sportistat e saj për të fituar eksperiencë të reja dhe përballje sportive të niveleve të larta; gjithashtu synon që këto kampiona, sportistë të kujtohen ndër vite për kontributin në sport dhe për paraqitjen që i kanë bërë dhe i bëjnë qytetit tonë. Bashkia Shkodër do të publikojë një organ informues sportiv përmbledhës për të gjithë ekipet e SK Vllaznisë, kampionatet sportive ku ekipet që mbështëten marrin pjesë, si edhe aktivitetet e tjera sportive që zhvillohen në Shkodër gjatë vitit. Ky projekt është tashmë një traditë. Turneu Ciklistik "Agim Tafili" Në territorin e Bashkisë së Shkodrës, zhvillohen shumë disiplina sportive, numri i fëmijëve që përfshihen në sporte të ndryshme është gjithnjë i konsiderueshëm. Vit pas viti Bashkia e Shkodrës po i jep mundësinë të zhvillohen, promovohen, afrohen aktivitetet ndërkombëtare në qytet. Pas mbështetjes disa vjeçare të ekipit të ciklizmit, rezultateve kombëtare dhe ndërkombëtare të larta që Kjo disiplinë ka arritur, pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare, këtë vit rimbështete një turne ndërkombëtar me ciklista. Ky aktivitet nuk ndalet vetëm në promovimin e këtij sporti por edhe në promovimin e qytetit, si qender e organizimit të disa aktiviteteve ndërkombëtare tashmë. Nga Ballkani por jo vetëm do jenë pjesëmarrës ekepe ku me mbështetjen edhe të Federatës së Çiklizmit do të zhvillojnë aktivitetin. Kinema e hapur Në territorin e Bashkisë Shkodër gjatë vitit organizohen shumë aktivitetet rinore, sportive, kulturore. Numri i të rinjve që punon për t'i organizuar apo bashkorganizuar këto aktivitetet është gjithmonë i madh, gjithmonë në rritje. Në qytet gjithashtu aktivitetet të tilla organizohen edhe në ambiente të jashtme. Në shesh vit pas viti Bashkia Shkodër ka organizuar "Koncertet e Verës", me synim promovimin e artistave të rinjë, ku vetë ato janë pjesëmarrës. Për herë të parë Bashkia Shkodër organizon netë të kinemasë të hapur. Në shesh kryesore të qytetit synohet të organizohet ambjenti për të shfaqur filma të cilët kanë bërë histori apo janë modern dhe po ndiqen nga të rinjtë. Kampionati i pavarësisë Lojrat me dorë në Shkodër kanë një traditë të hershme dhe histori të suksesshme në sportin shqiptar. Ekipet e basketbollit dhe të volejbollit për meshkuj e femra kanë arritur rezultate shumë të mira në të gjithë aktivitetet kombëtare duke përfaqësuar e përquar vlerat e qytetit në vende të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare. Deri në fillim të viteve 90 janë zhvilluar periodikisht kampionate të lojrave me dorë në mes të shkollave të mesme. Prej disa vitesh këto kampionate nuk zhvillohen, për pasojë është ulur numri i të rinjve që praktikojnë sportet e basketbollit dhe të volejbollit duke sjellë kështu edhe më pak talente për ekipet e Vllaznisë. Për vitin 2020 Bashkia Shkodër do të bashkëpunojë me Qendren Kulturore të Fëmijëve, SK Vllaznia dhe DAR për realizimin e këtij projekti, duku ofruar asistencën dhe profesionistët e duhur në ndihmë të aktivitetit. Ditët e vullnetarizmit Vullnetarizmi është një mundësi zhvillimi personal dhe profesional i të rinjve, gjë që shfrytëzohet pak nga të rinjtë e qytetit të Shkodrës. Të gjendur para këtij fakti dhe duke besuar në vlerat e vullnetarizmit, mendojmë të vazhdojmë të organizojmë aktivitetet të ndryshme vullnetarizmi të shtrira përgjatë vitit. Këto aktivitetet kanë për qëllim promovimin e vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimin e të rinjve për përfshirje më të madhe në jetën e qytetit. 		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> Synojmë edukimin e të rinjve për përfshirje më të gjërë në aktivitetet rinore, vullnetare, sportive. Synojmë promovimin e vullnetarizmit si mundësi për të fituar aftësi të reja si dhe për të përmirësuar kushtet e mjedisit. Synojmë gjallërimin e jetës sociale të të rinjve. Afrimin e të rinjve me njëri - tjetrin. Promovimi i sportit si veprimtari sociale, integruese dhe burim shëndetit. Synojmë të organizojmë aktivitetet rinore të cilat në të ardhmen mund t'i organizojnë vetë të rinjtë. Synojmë të promovojmë qytetin dhe njësitë administrative edhe tek turistat të cilët ndodhen në territorin e Shkodrës. 		



iii. Aktivitetet kryesore të projektit

b) Rezultatet që prisni

- Gjithëpërfshirja e moshave të reja në aktivitetet rinore të Bashkisë Shkodër.
- Pjesëmarrje aktive e të rinjve në aktivitete, afrimi i të rinjve me sportin.
- Argëtim dhe zbavitje për të rinjtë dhe qytetarët.
- Promovim i sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti.
- Mbështetje e profesionistëve në rang kombëtar.
- Përmirësimi i situatës mjedisore, sociale, rinore, kulturore si pasojë e zhvillimit të aktiviteteve vullnetare gjatë vitit.

c) Aktoret e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
<ul style="list-style-type: none">ZVA ShkodërShkollat 9 vjeçare dhe të mesme të Bashkisë ShkodërQendrat RinoreSportistëShoqata RinoreShoqata SportiveUniversiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”Komuniteti	Bashkia Shkodër Sport Klub Vllaznia Qendra Kulturore e Fëmijëve Federatat e ndryshme sportive Donatorë të mundshëm

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale
A.1	Honorare në Festivali i shahut : Kryegjyqtari 1x38000 Gjyqtarë: 3x12000 Cmimi i parë për dy kategori 2x12000 Cmimi i parë për kampionin e qytetit: 1x 20000	130			130		
A.2	Honorare për Kampionati i Pavarësisë: Arbitra 10x 12000	120			120		
A.3	Botim Revista Vllaznia	300			300		
A.4	Materiale publicitare	146			146		
A.5	Honorare për Kinema e hapur: Skenograf 1x100000 Regjizor 1x100000 Fonist 2x100000	400			400		
	Shuma	1096			1096		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale
A.1	Shpenzime operative	1096			1096		
	Shuma	1096			1096		

Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale
A.1	Shpenzime operative	1096			1096		
	Shuma	1096			1096		

f) Periudha e zbatimit

2020

2021

2022

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Institucioni likujdues : Bashkia Shkodër



Nr. 3	Projekti : P08130.O1.A3 Beach volley, volejboll	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081 Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130 Sport dhe argëtim					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit : Turne volejboli 3-ditor masiv dhe profesionist ne Nj.A Velipoje							
i. Situata							
Me ndarjen e re territoriale Bashkia e Shkodrës e ka shtuar sipërfaqen e saj me rreth 50 herë, duke u shtrirë nga alpet në veri deri në breg të detit Adriatik. Kjo shtrirje shton mundësitë e zhvillimit të sporteve që mundësohen nga bregu i detit dhe rëra. Velipoja është një nga plazhet me të frekuentuara në veriun e Shqipërisë dhe gjatë muajve të verës numri i frekuentuesve shkon deri në 100,000 pushues. Shumë të rinj ushtrojnë sporte të ndryshme që mundësohen nga stina e verës dhe nga prania e rërës në plazh, volejboli është një nga sportet më të preferuara të stinës së verës në Velipojë. Në këto rrethana të reja nga ana e Bashkisë së Shkodrës për të katërtin vit radhazi vlerësohet e rëndësishme nxitja e mbështetja e të rinjve që dëshirojnë të praktikojnë sport në plazh por edhe profesionistave, veçanërisht volejbollin në plazh. Vitin e kaluar organizimi në datat 26-28 korrik Beach Volley për profesionista mbledhi sportista nga qytetet e ndryshme të Shqipërisë dhe jo vetem duke krijuar një atmosferë, parapërgatitje për sezonin sportive në vijm si dhe njohje më të gjërë të Plazhit të Velipojës.							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none">Synojmë gjallërimin e jetës sportive në plazhin e Velipojës.Synojmë promovimin e sportit si instrument edukues.Synojmë të mbështesim profesionistët kombëtarë të volejbollit.Synojmë të promovojmë plazhin Velipojës.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none">Ngritja e grupit të punës me pjesëmarrjen e të rinjve të cilët duan të angazhohen në organizim.Programimi i aktiviteteve dhe axhendës së zhvillimit të aktivitetit.Përzgjedhja e vendeve ku do të krijohen fusha e “beach volley”Përgatitja dhe ndërtimi i fushës.Sigurimi i mjeteve të nevojshme si: rrjeta, mbajtëse të rrjetës, rrethimi i fushës, topat e volejbollit etj.Sigurimi dhe pagesa për arbitrat dhe përgatitja e çmimeve për fituesit.Sigurimi i vendqendërimit për pjesëmarrësit.							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none">Pjesëmarrje aktive e të rinjve në ndeshjet e beach volley.Argëtim dhe zbavitje për pushuesit.Promovim i sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti.Mbështetje të profesionistëve në rang kombëtar.Promovimi i turizmit në plazhin e Velipojës.							
c) Aktoret e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt					
Bashkia Shkodër Njësia Administrative Velipojë Mbështetës të aktivitetit		Bashkia Shkodër Sport Klub “Vllaznia” Federata shqiptare e Volejbollit Donatorë të mundshëm					
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Pagesa për arbitra 1 kryearbiter x 18 000 lek 10 arbitra x 12 000 lek	138			138		
A.2	Materiale publicitare	100			100		
A.3	Çmimet për fituesit: Vendi i parë 4 persona x 25000 lek Vendi i dytë 4 persona x 15000 lek Vendi i tretë 4 persona x 10000 lek	200			200		
A.4	Akomodim, trajtim ushqimor	724			724		
A.6	Uniforma për aktivitet	90			90		
	Shuma	1252			1252		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime Operative	1300			1300		
	Shuma	1300			1300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime Operative	1300			1300		



	Shuma	1300			1300		
f) Periudha e zbatimit 2020 2021 2022		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër					



Nr. 4	Projekti : P08130.O1.A4 Memorial "Vllaznia",boks	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081 Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130 Sport dhe argëtim					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Turne nderkombetar ne boks							
i. Situata Ekipi i boksit i të rriturve, SK "Vllaznia", që në vitin 2002, mer pjesë në në aktivitete ndërkombetare në bashkëpunim me federatën shqiptare të boksit sipas rregullores së Federatës Ndërkombëtare Europiane në boks in amator. Ekipi i të rriturve i Vllaznisë perbëhet nga 15 sportistë të ekipit kombëtar dhe 5 trajnerë. Ekipi i boksit të të rriturve ka marrë pjesë në këtë eveniment për 14 vite rresht duke dalë kampion në këtë aktivitet dhe duke marre medalje ari, argjendi dhe bronzi, gjithsej 48 medalje. Ne këto aktivitete prej 15 vitesh kanë marrë pjesë edhe shumë ekipe nga Kazakistani, Gjermania, Italia, Bullgaria, Hungaria, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Kanadaja, Australia, Kroacia, Armenia, Irlanda etj, në vitin prill 2019 morën pjesë ekipe nga Shqipëria, Kosova, Mal i Zi, Maqedoni, Kroaci, Bullgaria.							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i suksesshëm i aktivitetit ndërkombëtar "Memorial Vllaznia 2019". Promovimi i sportit në qytetin e Shkodrës në arenën ndërkombëtare 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Sigurim i mjeteve dhe aktiviteteve logjistike për mbarevajtjen e aktivitetit. Ofrimin e bazës materiale që nevojitet për zhvillimin normal të këtij aktiviteti. 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> Ekipi synon të zërë vendin e parë, duke marrë medalje ari, argjendi e bronzi. 							
c) Aktoret e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
SK "Vllaznia", shoqatat sportive, sponsorët, sportdashësit, Bashkia Shkodër.				Bashkia Shkodër Donatorët e mundshëm			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
A.1	Organizim i aktivitetit	400	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma	400				400	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
A.1	Organizim i aktivitetit	400	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma	400				400	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
A.1	Organizim i aktivitetit	400	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma	400				400	
f) Periudha e zbatimit 2020 2021 2022		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër					

Nr. 5	P08130.O1.A5 Ndertim Fusha Sportive	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081 Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130 Sport dhe argëtim
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Rikualifikimi i 3 fushave sportive ne shkollat e territorit te Bashkise se Shkodres		
i. Situata		
<p>Projekti "Jeto me Sportin" synon rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve të komunitetit në sa më shumë aktivitete sportive duke zhvilluar më tej traditat sportdashëse të banorëve e duke përmirësuar kështu cilësinë e jetesës së tyre.</p> <p>Vizioni i Bashkisë Shkodër është transformimi i territorit në një hapsirë policentrike që ofron shërbime me të njëjtin standard për publikun në mënyrë të thjeshtë dhe të aksesueshme nga banorët dhe vizitorët.</p> <p>Nxënësit, Shoqatat e klubet e ndryshme sportive për të rinj por edhe komuniteti kanë nevojë të jenë të angazhuar në aktivitete sportive nëterrene dhe ambiente të përshtatshme. Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Shkodër duhet të sigurojë infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e një numri të madh institucioneve arsimore për 11 njësitë administrative (90 shkolla, 58 kopshte, 2 konvikte dhe 1 shkollë speciale), që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Duke pasur një numër të madh nxënësish që frekuentojnë shkollat në Shkodër, ne duam të kontribuojmë jo vetëm në aktivitetet e edukimit dhe formimit por edhe për aktivitetet sportive, argëtuese e kreative si qendra komunitare në shërbim të komunitetit.</p> <p>Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Fondit të zhvillimit të Rajoneve ne thirrjen e pare per financimin e projekteve nga grantet "Arsimi", pjese e fondit per zhvillimin e rajoneve per vitin 2018 me shkresën nr prot 10430 date 27.04.2018. Thirrja ishte me kushtin qe 30% te fondit total do te mbulohej me fondet e bashkise. <i>Me deklaraten nr prot 6427 date 27.04.2018, Bashkia Shkoder ka marre persiper te bashkefinancoje 30% e projektit sipas miratimit te projektit "Ndertimi i fushave sportive (P9F1O2A14)" me VKB nr. 85, datë 26.12.2017 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2018 - 2020 të Bashkisë Shkodër".</i></p> <p>Projekti konsiston ne rikualifikimin e terreneve sportive në 3 shkolla të mesme të Bashkisë Shkodër, përkatësisht një në qytet dhe dy në njësitë administrative.</p> <p>Rikualifikimi i terreneve sportive në shkollën e Mesme të përgjithshme "Oso Kuka", qytet, pjesë e Lagjes Nr.2, me një popullsi rreth 35 mijë banorë; Sheshi i ndërtesës së Shkollës së Mesme të Përgjithshme "Oso Kuka", me një sipërfaqe rreth 2500 m2, aktualisht shfrytëzohet në mënyrë të improvizuar për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. Sipërfaqja e sheshit është pjesërisht e shtruar (me asfalt) ndërsa pjesa tjetër jo. Terreni ku zhvillohen aktivitetet sportive është në gjendje jo të mirë, duke penguar kështu ushtrimin normal të aktiviteteve sportive. Aktualisht mund të konstatohet që sheshi është i papërshtatshëm për çdo aktivitet sportiv dhe rekreativ</p> <p>Në shkollën e Mesme të Bashkuar At "Gjon Karma" Njësia Administrative Guri i Zi me një popullsi prej 11838 banorë; aktualisht nuk mund të shfrytëzohet për aktivitete sportive për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. E gjithë sipërfaqja e sheshit është e pashtuar, një pjesë e madhe e terrenit ku zhvillohen aktivitetet sportive është në gjendje jo të mirë, gjë që pengon në ushtrimin normal të proceseve mësimore dhe aktiviteteve sportive. Sheshi ku zhvillohen programet mësimore të edukimit fizik dhe aktivitetet sportive dhe rekreative është jashtë çdo standardi.</p> <p>Në shkollën e mesme "Gjimnazi Oblikë", Njësia Administrative Ana e Malit me një popullsi prej 5968 banorë. me një sipërfaqe rreth 2225 m2, aktualisht shfrytëzohet në mënyrë të improvizuar për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. E gjithë sipërfaqja e sheshit është e pashtuar, një pjesë e madhe e terrenit ku zhvillohet aktivitetet sportive është ne gjendje jo të mirë, gjë që pengon ushtrimin normal të aktiviteteve sportive. Aktualisht sheshi i planifikuar për zhvillimin e programit mësimor të edukimit fizik dhe aktiviteteve sportive dhe rekreative nuk plotëson kushtet për zhvillim të rregullt të këtyre aktiviteteve.</p> <p>Bazuar ne Vendimin e KZHR nr 7 date 11.05.2018 "Detajim i Fondit per zhvillimin e rajoneve" dhe shkresen e Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr prot 9795/3 date 06.06.2018 keto fonde per investime si bashkefinancim nga KZHR ne projektin "Jeto me Sportin" Rikualifikim i terreneve sportive ne shkollat " Oso Kuka" Shkoder, "Ana e Malit Oblike" dhe "At Gjon Karma" Gur i Zi jane akorduar programi 8140 "Zhvillimi i Sportit", zeri investime, ne instiucionin Bashkia Shkodër.</p> <p>Rimodelimi i të gjithë shesheve, si para ndërtesave, ashtu edhe prapa, i kthen këto sheshe në hapësira multifunkionale. Hapësirat rekreative do të mund të përdoren si nga nxënësit dhe mësuesit ashtu edhe nga i gjithë komuniteti në territorin administrativ ku ndodhen shkollat.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<p>Qëllimi i përgjithshëm i projektit 'Jeto me Sportin' është përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të Bashkisë Shkodër duke i mundësuar çdo fëmijë, të riut dhe të reje që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në aktivitetet sportive. Objektiv i këtij projekti është rikualifikimi i ambienteve dhe infrastrukturës sportive nëtreshkolla të Bashkisë Shkodër duke krijuar kushte sipas standardeve për zhvillimin e aktiviteteve sportive.</p>		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Rikualifikim i ambienteve sportive shkolla Oso Kuka; • Rikualifikim i ambienteve sportive shkolla At Gjon Karma; • Rikualifikim i ambienteve sportive shkolla Gjiminazi Oblikë; 		



b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i orëve të fiskulturës në mënyrë të rregullt. Zhvillimi i disiplinave të ndryshme sportive për nxënësit e shkollave. Hapja e shkolles si qender komunitare për nxënësit por edhe për të rinjtë që jetojnë aty. 						
c) Aktoret e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit Fondi për Zhvillimin e Rajoneve			Bashkia Shkodër Fondi për Zhvillimin e Rajoneve			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zbatimi i projektit	3229				3229
	Shuma	3229				3229
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit 2020 2021 2022		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër				



Nr.6	P08130.O2.A1. Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim																									
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Mirembajtja dhe administrimi i Sport Klub Vllaznia																											
i. Situata Sport Klub “Vllaznia” është themeluar në vitin 1919 me emrin KS Bashkimi ndërsa në 1929 u quajt Bashkimi Shkodran dhe në 1939 merr pjesë për herë të parë në Kampionatin Shqiptar të Futbollit të Kategorisë së parë. Në vazhdimësi Sport Klub Vllaznia, siç quhet sot, është dalluar në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare për rezultatet e larta në shumë disiplina sportive. Aktualisht Klubi menaxhon dhe zhvillon 15 disiplina sportive dhe përbën një ndër klubet më të rëndësishëm dhe më të suksesshëm në Shqipëri. Pikërisht edhe përmirësimi i performancës në administrimin e klubit me qëllim rritjen e performancës përbën edhe sfidën më të madhe për Bashkinë Shkodër në drejtim të zhvillimit të sportit në territorin e Shkodrës. Krijimi i kushteve sa më të mira për ushtrimin e aktiviteteve të disiplinave të ndryshme sportive do të krijonte kushte për rritjen si cilësore në rezultate më të larta ashtu edhe sasiore në rritjen e numrit të sportistëve. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli, bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.Me VKB nr. 82 date 28.12.2018 "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2019 dhe planit buxhetor afatmesem perfundimtar 2019-2021 të Bashkisë së Shkodrës"; është dheVKB 15 datë 09.10.2019 " Për një ndryshim në VKB nr. 82 date 28.12.2018 "Për miratimin e Buxhetit , për vitin 2019 dhe planit buxhetor afatmesem perfundimtar 2019-2021 të Bashkisë së Shkodrës" pagat dhe sigurimet paguhen per58 punonjës,prej te cileve 37 me kohë pune të pjeseshme. Ambjentet e Pallatit të Sportit Qazim Dervishi duhet të mirëmbahen vit pas viti në të gjithë komponentët e tij si zyra administrate, dhoma zhveshje, banjo etj. Gjithashtu parashikohen blerje pajisje orendi për këto ambiente. Për mbarrëvajtjen e stervitjes duhet të blihen vit pas viti materiale sportive si komplete sportive, topa, uniforma zyrtare për ndeshje. Mjetet kancelarike dhe materialet e pastrimit janë shumë të rëndësishme në mbarrëvajtjen e punës gjatë vitit si për administratën ashtu edhe për ambjentet e SK Vllaznia dhe terreneve sportive. Karburanti përdoret për shoqërimin e ekipit të ciklizmit në stërvitje dhe aktivitete zyrtare. Në vitin 2020 parashikohet të rikonstruktohen terrenet sportive, konkretisht salla e ndeshjeve të lojërave me dorë. Parketi duhet të riparohet dhe të lyhet me boje dhe llak sipas standarteve të kërkuara për zhvillimin normal të stërvitjeve dhe aktiviteteve sportive. Për të përmirësuar kushtet në të cilat zhvillohet sporti do kryhen edhe shpenzime të tjera si vendosje prozhektorë në sallën e ndeshjeve apo pajisje te tjera teknike e sportive. Blerje Pajisje TIK parashikon blerje PC për specialist pranë sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse si dhe video projector për analizat teknike të ndeshjeve. Shpenzimet e printimit dhe publikimit parashkohen për veshjen e xhamave të dhomave të zhveshjes së sportistëve dhe biletarisë së shitjes së biletave. Ambientet e pallatit gjatë zhvillimit të ndeshjeve apo aktiviteteve zyrtare kanë nevojë për pastrim me anë të një fshese profesionale me korent.																											
ii. Synimi i projektit Nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të Sport Klub Vllaznia synohet rritja e performancës së ekipeve sportive të SK Vllaznia.																											
iii. Aktivitetet kryesore të projektit <ul style="list-style-type: none">• Pagesë e faturave të energjisë elektrike dhe të ujit për te gjithë ambjentet ku sterviten ekipet e lojrave me dorë, boksit, peshëngritjes dhe ciklizmit.• Pagesë e faturave të internetit për administratën, federatat, trajnerët etj.• Blerje pajisje zyre per specialist/ inxhinier• Blerje të tjera për funksionimin e Sportklub Vllaznia dhe Pallatit të Sportit• Krijimi i kushteve per zhvillimin normal te aktiviteteve sportive duke riparuar parketin dhe sherbime tjera mirembajtjeje.• Zhvillimi i stërvitjeve në kushte normale me synim rritjen e cilësisë sportive.• Aktivitete miqësore.• Aktivitete kombëtare.• Aktivitete nderkombetare• Sigurohet zhvillimi normal i stervitjeve dhe pjesmarrja ne aktivitetet kombetare e nderkombetare te boksit.																											
b) Rezultatet që prisni <ul style="list-style-type: none">• Rezultate të larta të sportistëve të SportKlub Vllaznisë• Shpallje të ekipeve kampione kombëtarë																											
c) Aktoret e mundshëm Bashkia Shkoder		d) Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Shkodër																									
e) Shpenzimet e llogaritura																											
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		<table><tr><td rowspan="2">Totali (mijë lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr><tr><td>Paga</td><td>Siguri me</td><td>Operati ve</td><td>Transfe rime</td><td>Kapita le</td></tr><tr><td>A.1</td><td>Paga personeli</td><td>17,430</td><td>17,430</td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>A.2</td><td>Kontribute per sigurime shoqerore dhe</td><td>3.631</td><td></td><td>3.631</td><td></td><td></td></tr></table>	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					Paga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapita le	A.1	Paga personeli	17,430	17,430				A.2	Kontribute per sigurime shoqerore dhe	3.631		3.631		
Totali (mijë lekë)	Nga kjo:																										
	Paga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapita le																						
A.1	Paga personeli	17,430	17,430																								
A.2	Kontribute per sigurime shoqerore dhe	3.631		3.631																							



	shendetesore						
A.3	Energji elektrike	551			551		
A.4	Uje	250			250		
A.5	Sherbime interneti	100			100		
A.6	Sherbime postare	5			5		
A.7	Shpenzime për mirëmbajtje pajisjeve të zyrave	50			50		
A.8	Blerje unifroma dhe materiale sportive	850			850		
A.9	Blerje kancelari	60			60		
A.10	Blerje materiale per pastrim, dezinfektim,ngrohje, ndricim	60			60		
A.11	Blerje karburant	250			250		
A.12	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	400			400		
A.13	Blerje boje muuri per ambientet e brendshme	100			100		
A.14	Blerje bileta	50			50		
A.15	Shpenzime të printimit dhe publikimit	100			100		
A.16	Blerje prozhektore per ndriçimin e fushës së stërvitjes të Pallatit të Sportit "Qazim Dervishi"	100					100
A.17	Blerje Pajisje TIK	100					100
A.18	Rikonstrukcion terren sportive (salla e ndeshjeve lojera me dore 700m2)	1,030					1,030
A.19	Blerje orendi dhe pajisje zyre	100					100
A.20	Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune	100					100
A.21	Blerje pajisje pastrimi –fshese me korent profesionale	70					70
	Shuma	25,387	17,430	3,631	2,826		1,500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapita le
A.1	Paga dhe sigurime shoqerore	21,374	17,670	3,704			
A.2	Shpenzime operative	2,951			2,951		
A.3	Investime	1,500					1,500
	Shuma	25,825	17,670	3,704	2,951		1,500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapita le
A.1	Paga dhe sigurime shoqerore	21,374	17,670	3,704			
A.2	Shpenzime operative	2,951			2,951		
A.3	Investime	1,500					1,500
	Shuma	25,825	17,670	3,704	2,951		1,500
f) Periudha e zbatimit Janar 2020- Dhjetor 2020 Janar 2021- Dhjetor 2021 Janar 2022- Dhjetor 2022		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kulturës, Arsimit Rinisë dhe Sportit Sport Klub Vllaznia Institucioni likuidues :Sport Klub Vllaznia					



Nr.7	P08130.O2.A2.	Funksioni 8:Argëtim, kultura dhe feja					
	Administrimi dhe Mirembajtje e objekteve/terreneve sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër	N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:Mirëmbajtje e objekteve, terreneve, fushave sportive të Bashkisë Shkodër.							
i. Situata							
<p>Stadiumi “Loro Boriçi” është pasuri e paluajtshme, pronë publike, në pronësi të Bashkisë Shkodër. Kjo pronë ka kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër me VKM nr. 421, date 2.6.2010 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër”, me nr. 221 rendor në listë të inventarit.</p> <p>Këshilli Kombëtar i Territorit të Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 1, datë 1.4.2015 ka miratuar kërkesën e Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) për të investuar në rikonstruksionin e këtij objekti. Përfutues i këtij investimi është Bashkia Shkodër. FSHF dhe Bashkia Shkodër kanë nënshkruar një Marrëveshje (Nëntor 2015) me qëllim bashkëpunimin për rikonstruksionin, përdorimin dhe manaxhimin e këtij impianti sportiv në pronësi të Bashkisë Shkodër pas realizimit të konstruksionit të Stadiumit “Loro Boriçi”.</p> <p>Me datë 06.03.2019 në prani të personit të autorizuar nga Bashkia Shkodër u dorëzua nga personi i autorizuar nga FSHF dokumentacioni origjinal : Relacion përmbledhës i mbikqyrsit të punimeve, Situacion përfundimtar i punimeve, Akt kolaudimit përfundimtar të projektit, Shkresë nga UEFA ku stadiumi plotëson standartet e kategorisë 4, Certifikatë e përhershme e marrjes në dorëzim, Libreza e masave dhe vizatime të stadiumit final.</p> <p>Të gjitha institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore krijojnë kushtet e nevojshme që nxënësit, studentët, efektivat e policisë dhe të Forcave të Armatosura të zhvillojnë veprimtari fizike dhe sportive, individuale dhe/ose të organizuara.</p> <p>Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikat vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitar, krijon institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre</p> <p>Fusha e lekuraeështë një nga infrastrukturat sportive në pronësi të Bashkisë Shkodër ku zhvillohen trajnimet dhe ndeshjet e akademisë së futbollit, për ekipet e grupmoshave. Prej disa vitesh këto terrene janë përdorur nga Klubi i futbollit “Vllaznia”. Bashkia Shkodër, duke qenë pronare e objektit, ka trashëguar një detyrim të pa shlyer për shërbimin e energjisë elektrike. Këto shpenzime nuk janë planifikuar vitet e kaluara për t’u financuar as nga Bashkia Shkodër e as nga Klubi i Futbollit “Vllazinia”. Pasi është vlerësuar dhe rakorduar për të gjithë vitet me operatorin OSHEE lind e domosdoshme lidhja e një marëveshje për shlyerjen e këtij detyrimi me këste.</p>							
ii. Synimi i projektit							
